REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 732/20
Date/Datum. 04.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.732/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Blerim Dina-Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues dhe Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Olti Trasing" Shpk - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Alba Konstruksion" Shpk - Tiranë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i sheshit Adem Preniqi", me nr. prokurimi 614-20-3884-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal-Obiliq, me datën: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit OE "Olti Trasing" Shpk - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i sheshit Adem Preniqi", me nr. prokurimi 614-20-3884-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Obiliq.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i sheshit Adem Preniqi", me nr. prokurimi 614-20-3884-5-1-1, iniciuar nga AK KK Obiliq.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Olti Trasing" Shpk - Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik "Olti Trasing" Shpk - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 07.10.2020 me nr. 732/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë, OE "Alba Konstruksion"-Shpk - Tiranë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i sheshit Adem Preniqi", me nr. prokurimi 614-20-3884-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Obiliq, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 40 dhe 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 07.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 16.10.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin 1, Lidhur me pretendimin e OE ankues "Olti Trasing" Shpk - Prishtinë, se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar kontrata të natyrës së njëjtë në tri vitet e fundit jo më pak se 1,000,000.00 €, që sipas OE ankues kontratat dhe referencat e dorëzuara e tejkalojnë këtë vlerë dhe AK gjatë vlerësimit të tenderëve ka bërë shkelje të nenit 1,6,7,59,60 të LPP-së, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit tek kërkesa 1. e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë në (3) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se;1,000,000.00 €. Në rast të grupit Lideri duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të natyrës së njëjtë, e dëshmuar me listën e kontratave të realizuara, sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 6, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e punëve.

Kerkesa nr.1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë në (3) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se;1,000,000.00 €. Në rast të grupit Lideri duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të natyrës së njëjtë

Dëshmia nr.1 Lista e kontratave të realizuara, sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 6, ku duhet saktësuar titullin e* kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e punëve.

Publikimi i njoftimit për kontrate 22.07.2020.

OE ankues "Olti Trasing" Shpk se bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar edhe listën e kontratave të realizuara konform Aneksit 6.të dosjes së tenderit të dëshmuara me kontrata dhe referenca për realizimin e tyre.

OE ankues "Olti Trasing" Shpk ka dorëzuar kontratën e lidhur me Komunën e Lipjanit për "Ndërtimi i sheshit Adem Jashari" e lidhur me datë 11.10.2016 me nr prokurimi 613-016-069-5-1-1 në vlerë prej 465,757.77 €. Gjithashtu është dorëzuar edhe certifikata e pranimit të punimeve e datës 05.12.2018 që është konform kërkesës së dosjes së tenderit. Gjithashtu OE "Olti Trasing" Shpk ka dorëzuar edhe kontratën dhe aneks kontratën me Ministrinë e Administratës Publike për "Ndërtimi i ndërtesës së IKAP Lot 10" e lidhur me 14.11.2016 në vlerë prej 1,643,051.43 € dhe 38,022.36 € për aneks kontratën. OE ankues ka bashkangjitur edhe referencën për realizimin e punimeve të datës 13.03.2020.

Eksperti shqyrtues sqaron se kjo kontratë dhe referenca për realizimin e kësaj kontrate e prezantuar nga OE ankues duhet të konsiderohet e natyrës së njëjte për shkak se paramasa/pozicionet për punët që do të kryhen në aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i sheshit Adem Preniqi" siç janë pozicionet e instalimeve elektrike, instalimet e ujit, punët e betonit, gjelbërimit, ndërtimi i mureve, vendosja e kubëzave/pllakave, etj. janë të natyrës së njëjtë me pozicionet/punët që janë realizuar në kontratën e prezantuar nga OE ankues. Andaj, sipas ekspertit shqyrtues kjo kontrate dhe disa kontrata tjera të punëve të prezantuara nga OE ankues janë konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe përmbushin vlerën e kërkuar prej 1,000,000.00 €. Pretendimi ankimor është i bazuar

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim.**

Autoriteti Kontraktues, me datën 21.10.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Sqarim i AK:

Autoriteti Kontraktues NUK pajtohet me mendimin e ekspertit që lënda të kthehet në rivlerësim për projektin Ndërtimi i sheshit Adem Preniqi .

Arsyetim:

OE Ankues Olti Trasing SH.P.K., Bill Klinton, 10000, PRISHTINE

- Te pjesa Kërkesat mbi mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

- kerkesa nr.1 AK ka kerkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë në (3) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se;1,000,000.00 €. Në rast të grupit Lideri duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të natyrës së njëjtë
- AK gjatë vlerësimit të ofertës së OE Olti Trasing.,duke u bazuar në Listën e dorëzuar te projekteve të realizuara dhe në dëshmitë e ofruara vërteton se OE Olti Trasing. ka afruar referenca të natyrës së njëjtë në vlerë prej 465.757.70 euro Ndërtimi i sheshit Adem Jashari në komunën e Lipjanit, ndërsa referencat dhe punët tjera i ka vetëm në ndërtim te objekteve banesore.
- OE në listën e projekteve të realizuara si dhe tek dëshmitë e ofruara NUK ka paraqitur refrenca, punë të natyrës së njëjtë për periudhën e shkuar 3 vjeçare, shuma e paraqitur për kryerjen e punëve të njëjta nuk i përmbush kërkesat sipas FDT neni 9.1 & 9.2,prandaj Operatori ekonomik NUK i plotëson Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Operatori Ekonomik nuk e ka njoftuar OSHP-në se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Olti Trasing" Shpk - Prishtinë, se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar kontrata të natyrës së njëjtë në tri vitet e fundit jo më pak se 1,000,000.00 €, që sipas OE ankues kontratat dhe referencat e dorëzuara e tejkalojnë këtë vlerë dhe AK gjatë vlerësimit të tenderëve ka bërë shkelje të nenit 1,6,7,59,60 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues sqaron se AK në dosjen e tenderit,

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 ka paraparë :
Kapaciteti teknik dhe professional: Kerkesa nr.1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë në (3) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se;1,000,000.00 €. Në rast të grupit Lideri duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të natyrës së njëjtë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: **Dëshmia nr.1 Lista e kontratave të realizuara, sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 6, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e punëve.**

Ndërsa ne aneksin 6 Autoriteti Kontraktues ka kërkuar si me poshtë :

Aneksi 6. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS[2]

Aneksi 6 është obligativ të plotësohet dhe duhet të jetë në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga OE.
- Bashkëngjit: Dëshmitë e përfundimit të punëve.si Referenca/t ose procesverbali/et e pranimit të punëve ose ndonjë dokument tjetër që evidenton punët e natyres së njejtë }.

NR.	Titulli i kontrates	Data e nenshkrimit te kontrates	Data e Perfundimit te kontrates	Vlera e ekzekutuar e kontrates	Emri i Bleresit	Nurmi i telefonit te Bleresit
1						
2						

(Shto/fshij sipas nevojes)

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Ankes dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listen e zezë te Operatoreve Ekonomik.

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

Autoriteti Kontraktues e ka publikuar njoftimin per kontrate per këtë aktivitet me date 22.07.2020 dhe sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktues siç është cekur me larte se **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë në (3) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se;1,000,000.00 €.** Qe do te thotë se është kërkuar per periudhën 22.07.2017 deri me 22.07.2020 dhe nëse e shikojmë listën e kontratave te prezantuar nga Operatori Ekonomik ankues do te shohim si me poshtë:

OE Ankues Olti Trasing ka prezantuar vetëm një kontrate te natyrës se njëjtë, atë me numër rendor 7 sipas radhitjes ne liste në vlerë prej 465.757.70 euro, Ndërtimi i sheshit Adem Jashari në komunën e Lipjanit, ku edhe kjo kontrate sipas përshkrimit shihet se ka filluar para periudhës se kërkuar kohore pra ne vitin 2016 ndërsa ka përfunduar ne vitin 2018 dhe periudha e kërkuar kohore është nga 22.07.2017 pra nuk dihet se brenda periudhës kohore te kërkuar nga Autoriteti Kontraktues se sa pune janë kryer.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, duke rekomanduar për dhënie te kontratës Operatorin Ekonomik që ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim me te lire nga te gjithë ofertuesit e përgjegjshëm. Dhe se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave i është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Blerim Dina

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK– Kuvendi Komunal-Obiliq;

1x1 OE "Olti Trasing"Shpk – Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.